

VENDIM
Nr.424, datë 21.3.2006

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK ME PËRSËRITËS “DEUTSCHE WELLE”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të “Rregullores mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.162 të KKRT-së, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, si dhe të kërkesës së subjektit të interesuar, Këshilli Kombëtar i Radios dhe I Televizionit

VENDOSI:

1. Në mbarim të afatit të licencimit sipas licencës nr.001/PPH, të rinovojë për një afat të ri 4-vjeçar për ritransmetimin e programeve të huaja radio me përsëritës subjektin “Deutsche Welle”.
2. Kushtet e licencës, sipas pikës 1 të këtij vendimi, mbeten të pandryshuara.
3. Ky vendim hyn në fuqi në datën 14.1.2006 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Halil Lalaj